



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES**  
**SË KONSUMATORIT**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SIGURISË USHQIMORE DHE**  
**E MBROJTJES SË KONSUMATORIT**  
**DSHKMB**

Adresa: "Sheshi Skënderbej", Nr. 2, Tiranë

Tel/Fax +355 04 22 55 39

Nr. 3600 Prot.

Tiranë, më 2-08 2006

**UDHEZIM**

Nr. 381 datë 2.08.2006

**PËR**

**DISA MASA MBI ZBATIMIN E RREGULLORES NR.3 DATE 26.7.1999 MBI**  
**KUSHTET E TREGTIMIT TE KAFSHEVE DHE PRODUKTEVE TE**  
**AKUAKULTURES**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 86, të Ligjit Nr. 9308, datë 04. 11. 2004 "Mbi Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar", të Direktives 2004/453/CE, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**UDHEZOJ:**

1. Përcaktimin e disa masave për zbatimin e Rregullores Nr. 3 , dt. 26.07.1999 "Mbi kushtet e tregtimit të kafsheve dhe produkteve të akuakultures".
2. Kërkesat që duhet të plotsojë territori i Republikës së Shqipërisë që të konsiderohet i pastër nga një ose me shumë semundje të listuara në Kollonën I, Lista III e Aneks-it A të Rregullores Nr.3 date 26.7.1999 "Mbi kushtet e tregtimit të kafsheve dhe produkteve të akuakultures", janë të përcaktuara në Aneks-in I, Kapitulli I i këtij udhezimi.
3. Territorët e listuara në Aneks-in I, Kapitulli II i këtij Udhezimi, janë të pastra nga semundjet e listuara në Kollonën I, Lista III e Aneks-it të Rregullores Nr.3 date 26.7.1999 "Mbi kushtet e tregtimit të kafsheve dhe produkteve të akuakultures".
4. Kriteret për hartimin e programeve të kontrollit dhe çrrenjosjes për një ose me shumë semundje të Kollonës I, Lista III e Aneksit A, janë përcaktuar në Aneksin

II, Kapitulli I i Rregullores Nr.3 date 26.7.1999 "Mbi kushtet e tregimit te kafsheve dhe produkteve te akuakultures".

5. Peshku i gjalle i akuakultures, vezet, gametat e tij qe futen ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe ne territoret e listuara ne Aneksin I, Kapitulli II duhet te jete ne perputhje me kushtet lidhur me etiketimin dhe paketimin si dhe kerkesa te tjera shtese.
6. Kerkesat e pikes 1 nuk zbatohen kur: vezet jane futur ne territoret e listes se Aneksit I, Kapitulli II per konsum human.
7. Peshku i gjalle me origjine akuakulture, vezet e tij, gametat qe hyjne ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe ne territoret e listes se Aneksit I, Kapitulli II, duhet te transportohen sipas kushteve higjienike qe nuk demtojne statusin e tyre shendetsor as statusin shendetsor te Republikes se Shqiperise.
8. Për zbatimin e këtij udhezimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky Udhezim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Jemin GJANA**